

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT,
FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

RAPORTI VJETOR

2016

Përmbajtja

Misioni i AKAFPK-së _____	3
Të dhëna të përgjithshme (kontakte/struktura) _____	4
Struktura dhe organika _____	4
Kontaktet _____	5
AKRONIME _____	6
Përmbledhje / Executive Summary _____	7
REZULTATET SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË _____	10
I. Veprimtaritë e Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale _____	10
II. Veprimtari lidhur me Kualifikimet profesionale _____	13
II.1. Draft lista kombëtare e kualifikimeve profesionale _____	13
II.2. Përshkrimet të kualifikimeve profesionale _____	14
III. Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për KSHK dhe anëtarësimin në Grupin Këshillimor të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) _____	14
IV. Veprimtari në kuadër të zbatimit të projektit “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”, financuar nga ERASMUS +, si dhe të projektit për “Platformën elektronike të të nxënësve të rriturve” (EPALE) _____	15
V. Bashkëpunim me MMSR dhe institucione të tjera _____	15
VI. Kontribute në kuadrin e zhvillimit të bashkëpunimit me agjenci homologe dhe me projekte të tjera _____	16
VEPRIMTARITË E SEKTORIT TË SKELETKURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË TRAJNIMIT TË MËSUESVE _____	18
VII. Kontributet e Sektorit të SSTM _____	18
VII.1 Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit kurrikular për AFP dhe mbështetja e zbatimit të tij _____	18
VII.2 Trajnimi dhe udhëzimi i mësuesve dhe drejtuesve në AFP _____	19
VII.3 Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve _____	20
VII.4 Veprimtari në kuadrin e angazhimit në Projekte të AKAFPK-së _____	21
VII.5 Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimit me donatorët dhe institucionet ndërkombëtare, si dhe në veprimtari kombëtare/ndërkombëtare për AFP _____	22
VII.6 Veprimtari të tjera _____	23
VEPRIMTARITË E SEKTORIT TË VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE DHE AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË _____	24
VIII. Veprimtari për zhvillimin e kritereve dhe standardeve të vlerësimit dhe certifikimit të nxënësve/kursantëve _____	24
VIII.1 Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të niveleve _____	24
VIII.1.1 Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale _____	25

VIII.1.2 Banka testesh	25
VIII.1.3 Certifikimi	25
VIII.1.4 Njehsim programesh studimi	25
VIII.2 Sigurimi i Cilësisë	26
VIII.3 Referencimi me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve	26
VIII.4 Veprimtari në kuadër të bashkëpunimeve	26
VIII.5 Veprimtari në kuadër të projektit të USAID dhe SHUKALB:	28
VIII.6 Të tjera	28
VEPRIMTARITË E SEKTORIT TË ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	29
IX. Kontributet e Sektorit të AF&TI	29
IX.1 Burimet njerëzore	29
IX.2 Arkivat	30
IX.3 Procedurat e transferimit të nxënësve në arsimin e mesëm profesional	30
IX.4 Faqja e internetit	30
IX.5 Zbatimi i projekteve në kuadër të programit Erasmus+	31
IX.6 Financa	31
IX.7 Të tjera	34
ANEKSE	35
ANEKSI I	35
ANEKSI II	36
ANEKSI III Lista e produkteve të SSTM për vitin 2016	37

Misioni i AKAFPK-së

AKAFPK-ja ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Në përmbushje të misionit të saj, AKAFPK-ja kryen funksionet e mëposhtme:

- Harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, Listën Kombëtare të Kualifikimeve profesionale, nivelet dhe standardet përkatëse
- Harton dhe rishikon skelet-kurrikulat e kualifikimeve profesionale;
- Harton dhe rishikon standardet e trajnimit të mësimdhënësve të AFP-së;
- Përcakton parimet dhe kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për kualifikimet profesionale;
- Akrediton institucionet e AFP për kualifikimet profesionale;
- Lëshon certifikatat e kualifikimeve profesionale për individët;
- Siguron që standardet e kompetencave të jenë në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe Sistemin Evropian të Krediteve për AFP-në;
- Siguron bashkëveprimin e të gjithë aktorëve kontribues të shoqërisë, në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.


Të dhëna të përgjithshme (kontakte/struktura)

Struktura dhe organika

Përcaktimi i strukturës dhe organikës së AKAFPK-së është sanksionuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.321, datë 21.4.2011 "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE".

Struktura dhe organika e AKAFPK-së, të cilat gjatë vitit 2015, nuk kanë pësuar ndryshime ka gjithsej 16 punonjës.

Struktura organizative e saj është si më poshtë:



Kontaktet

Sonila Limaj

Drejtor i AKAFPK Tel: 042237087/11 Fax: 042223795

Email: Sonila.Limaj@akafp.gov.al

Ejvis Gishti

Pergjegjese e Sektorit te Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

Tel: 042237087/19

Email: Ejvis.Gishti@akafp.gov.al

Alqi Mustafai

Pergjegjes i Sektorit te Skelet-Kurikulave dhe Standardeve te Trajnimit te Mesuesve te AFP

Tel: 042237087

Email: Alqi.Mustafai@akafp.gov.al

Lindita Dhima

Pergjegjese e Sektorit te Vleresim-Certifikimit te Nxenesve dhe Akreditimit te Ofruesve te AFP

Tel: 042237087/18

Email: Lindita.Dhima@akafp.gov.al

Teuta Braço

Pergjegjese e Sektorit te Administrates, Finances dhe Teknologjise se Informacionit

Tel: 042230497/20

Email: Teuta.Braco@akafp.gov.al

AKRONIME

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
ETF	European Training Foundation Fondacioni Evropian i Trajnimeve
DRFPP	Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik
ISCED	International Standard for Classification in Education Standardi Ndërkombëtar për Klasifikim në Arsim
ILO	International Labor Organisation Organizata Ndërkombëtare e Punës
LKP	Lista Kombëtare e Profesioneve
KShK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
SPKP	Spektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale
SSTM	Spektori i Skeletkurrikulave dhe STandardevë të Trajnimit të Mësuesve
SCVA	Spektori i Certifikimit, Vlerësimit dhe Akreditimit të Ofruesve të AFP-së

Përmbledhje / Executive Summary

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) gjatë vitit 2016 ka realizuar veprimtaritë e saj në bazë të planit vjetor të punës të miratuar nga drejtori, mbështetur në VKM nr.321, datë 21.4.2011 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”.

Prioritetet e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, baza ligjore dhe buxheti vjetor i miratuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për vitin 2016 përbënë kuadrin rregullator dhe përcaktues të veprimtarive të realizuara gjatë këtij viti.

Në këtë kuadër, AKAFPK ka realizuar veprimtari, rezultatet e të cilave projektojnë dhe mbështesin zhvillimin e ofertës së arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri.

Një nga produktet kryesore të punës gjatë vitit 2016 ishte përfundimi i procesit të plotë të rishikimit të Listës Kombëtare të Profesioneve, një standard kombëtar për klasifikimin e profesioneve bazuar në ISCO 2008¹.

Lista e rishikuar tërësisht është miratuar në Këshillin Kombëtar të Nomenklaturave dhe i është përcjellë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për t’u miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Zbatimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve është fokusuar në dy shtylla kryesore:

1. Angazhimi në Task Forcën e përbashkët për rishikimin e Ligjit nr.10247 datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” si dhe nisja e procesit të referencimit të KShK-së me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Në kuadër të procesit të referencimit, AKAFPK përfaqësohet në Bordin Këshillimor të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve me një anëtar të emëruar nga qeveria shqiptare. Në kuadër të punës së Task Forcës për KShK-në, AKAFPK është mbështetur me ekspertizë nga Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF) në hartimin e Manualit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në organizimin e punës për procesion e referencimit me KEK.
2. Realizimi i studimeve, hartimi dhe rishikimi i përshkruesve të kualifikimeve të niveleve II, III dhe IV të KShK-së.

Mbi bazën e përshkruesve të kualifikimeve janë hartuar 15 (pesëmbëdhjetë) skelet-kurrikula të reja (programet e arsimit profesional në nivel kombëtar) dhe janë rishikuar 5 skelet-kurrikula të niveleve II, III dhe IV të KShK-së (përkatësisht niveli I, II dhe III i arsimit profesional sipas ISCED).

Në mbështetje të zbatimit të programeve kombëtare dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në AFP, janë hartuar 13 materiale mësimore mbështetëse.

Agjencia Kombëtare e AFP-së është angazhuar në konceptimin dhe implementimin e programit të trajnimit 24-ditor “Bazat e didaktikës në AFP”. Gjatë vitit 2016, në sajë të

¹ International Standard Classification of Occupations 2008

mbështetjes së programit të GIZ-së, është hartuar manuali i plotë i trajnimit dhe është certifikuar 40 mësues të AFP-së, të cilët kanë përfunduar me sukses programin 24-ditor të trajnimit.

Procesi i vlerësimit dhe certifikimit të nxënësve në AFP është mbështetur me hartimin e 23 programeve orientuese për maturën shtetërore profesionale dhe provimet e niveleve të arsimit të mesëm profesional. Si rrjedhojë e ndryshimeve të disa aspekteve ligjore, 26 programe orientuese ekzistuese u plotësuan duke marrë në konsideratë këto ndryshime.

Gjatë vitit 2016 me mbështetjen e programit “Zhvillimi i aftësive për punësim” i zbatuar nga UNDP është hartuar dhe konsultuar Udhëzuesi i Vetëvlerësimit për ofruesit e AFP-së.

Një dimension shumë i rëndësishëm i punës së AKAFPK-së për vitin 2016 ishte edhe zbatimi i dy projekteve të bashkëfinancuara nga programi Erasmus+ i Komisionit Evropian.

Në kuadër të projektit projektit “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri” (Marrëveshja e Grantit nr. 2014-3228), në vitin 2016 u hartua “Udhërrëfytyesi për zbatimin e modelit dual bashkëpunues”, u hartuan standardet e profesioneve “kuzhinier” dhe “receptionist”, u hartuan përshkruesit përkatës të kualifikimeve profesionale, u rishikuan skelet-kurrikulat e të dy profileve dhe u siguruan praktikantët në biznes për 107 nxënës të shkollave Hoteleri-Turizëm Tiranë dhe shkollës profesionale Kamëz, respektivisht 3 ditë në javë në reception dhe 2 ditë në javë në kuzhinë.

Projekti u ndërpre në periudhën maj – shtator 2016 për shkak të pezullimit të pagesës së kështit të dytë nga Komisioni Evropian për mosshlyerje të detyrimeve nga shteti shqiptar, arsye të cilat ishin jashtë kontekstit të zbatimit të projektit nga AKAFPK. Me Aktin Normativ nr.1, datë 29.7.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, projektit iu vu në dispozicion një pjesë e fondit të pezulluar dhe kjo krijoi mundësinë e rinisjes së tij.

Projekti për promovimin e Platformës Elektronike për të Nxënësit e të Rriturve në Evropë (EPALE) u zbatua në periudhën 1.1.2016-31.12.2016 në zbatim të Marrëveshjes së Grantit nr. 2015-3358. Për promovimin e kësaj platforme, AKAFPK ngriti një ekip për menaxhimin dhe zbatimin e projektit, i cili zbatoi planin e aktiviteteve duke zhvilluar: një takim në Tiranë si dhe katër takime rajonale në Shkodër, Elbasan, Vlorë dhe Korçë me përfaqësues të sektorëve të arsimit të lartë, arsimit dhe formimit profesional, punësimit, organizatave dhe projekteve në këto fusha. Në zbatim të këtij projekti, AKAFPK kontribuoi rregullisht në promovimin e EPALË me rreth 600 persona të regjistruar në këtë platformë, 28 studime, artikuj dhe blogje të publikuara në këtë platformë mbarëevropiane.

Gjatë vitit 2016, AKAFPK ka arritur të shpenzojë 80% të zërit 602 të buxhetit. Arsyet kryesore për mosrealizimin e plotë të buxhetit për vitin 2016 ishte mungesa e bazës ligjore

për zbatimin e programit të trajnimit 24-ditor “Bazat e didaktikës në AFP”, zbatimi i të cilit u realizua me mbështetjen financiare të programit të GIZ-së.

AKAFPK mund të realizojë misionin e saj, vetëm nëse përmirësohet kuadri ligjor, realizohet ristrukturimi institucional dhe rritet buxheti vjetor i institucionit. Plani i punës së institucionit është rishikuar gjatë vitit në përputhje me zhvillimin e kuadrit ligjor dhe të prioritetëve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për vitin 2016.

Sonila LIMAJ
DREJTOR

Rezultatet sipas fushave të veprimtarisë

I. VEPRIMTARITË E SEKTORIT TË PROFESIONEVE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Zhvillimet e profesioneve në tregun e punës janë tepër dinamike dhe duhet një informacion i përditësuar lidhur me këto ndryshime. Në kuadrin e rishikimit të Listës Kombëtare të Profesioneve, janë zhvilluar takime me përfaqësues të INSTAT, si ndër përdoruesit kryesorë të saj, për ta bërë këtë klasifikim një instrument të vlefshëm në prodhimin e statistikave kombëtare të krahasueshme me ato ndërkombëtare. Për të evidentuar zhvillimet rajonale të profesioneve janë realizuar takime konsultuese me administratorë, specialistë të burimeve njerëzore, punonjës të kompanive të ndryshme, përfaqësues të zyrave të punës dhe të pushtetit lokal në Tiranë, Lushnjë, Shkodër dhe Pogradec për të marrë informacion të strukturuar lidhur me të gjitha profesionet, por në veçanti për profesionet e fushës së bujqësisë dhe zejeve.

Me mbështetjen e Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” (2014-2018), i financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), dhe në bashkëpunim me Biznes Albania, Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale ka vijuar procesin e rishikimit të Listës Kombëtare të Profesioneve duke e përditësuar me të rejat në fushën e zhvillimit të profesioneve në tregun shqiptar të punës, duke bërë në të njëjtën kohë edhe harmonizimin e këtij instrumenti me klasifikimin ndërkombëtar ISCO 2008². Gjithahstu, janë rishikuar grupet 0 dhe 1 në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë e Mbrojtjes.

Në vijim të këtij procesi, informacioni i grumbulluar nga mbi 130 subjekte duke përfshirë Ministrinë, partnerët socialë, INSTAT, kompani biznesi dhe institucione të tjera qendrore si SHKP, DAP, etj. (përmes shkresave, intervistave, takimeve etj.), lidhur me Listën ekzistuese të Profesioneve (e miratuar me VKM Nr 627, datë 11.6.2009), u inventarizua në një bazë të dhënash me rreth 3000 lloje punësh, dhe u përpunua në Sektorin e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale (SPKP) deri në daljen e një drafti fillestar të listës së rishikuar të profesioneve.

Drafti fillestar i LKP së rishikuar u dërgua sërish për t’u validuar në të gjitha Ministrinë, partnerët socialë, INSTAT, kompani biznesi dhe institucione të tjera, u zhvilluan takime shpjeguese dhe orientuese, si dhe u sigurua një proces komunikimi i vazhdueshëm verbal me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces.

² International Standard Classification of Occupations 2008

Gjatë këtij viti, u hartuan dhe finalizuan përshkrimet 310 profesioneve pjesë përbërëse e grupeve të mëdha 2-9 në LKP për sektorin privat dhe 136 përshkrimeve të profesioneve për sektorin publik, sipas formateve të paracaktuara nga SPKP dhe nën këshillimin dhe mbikëqyrjen e SPKP. Gjithashtu, u validuan edhe përshkrimet e 253 profesioneve nga sektori privat.

Së fundi, u hartua dhe u redaktua drafti përfundimtar i rishikuar i LKP-së duke bërë pasqyrimin e komenteve të përdoruesve, dhe duke e kthyer tashmë draftin e klasifikimit të profesioneve në një instrument për kapjen e informacionit aktual mbi profesionet në vend. Në mbështetje të përdoruesve është hartuar edhe tabela Korresponduese e LKP e rishikuar 2016 me LKP 2009 dhe ISCO 2008.

Drafti i rishikuar i LKP përfshin 2 komponentë kryesorë:

1. klasifikimin në vetvete, i cili bazohet në llojin e punës dhe në kompetencën e nevojshme, klasifikon profesionet (emërtimet përkatëse pa përshkrimet e tyre), duke filluar nga niveli më i lartë i agregimit që ka të bëjë me grupet kryesore të profesioneve, deri në nivelin më të ulët, që ka të bëjë me punët apo punësimet, duke përfshirë 10 grupe të mëdha, 43 nën grupe të mëdha, 133 grupe të vogla, 480 grupe njësi dhe 5489 punë.
2. 666 përshkrime të profesioneve (një fjalor profesionesh) të cilat përmbajnë përshkrime të funksioneve dhe detyrave të profesioneve dhe informacione të tjera të vlefshme që lidhen me profesionet deri në nivelin 4-shifror, me kontributin e ekspertëve të profesionit në vend.

Tabela përmbledhëse 1: LKP 2009 -LKP 2016

NR	Grupet e mëdha	Nën-grupet e mëdha		Grupet e vogla		Grupet njësi		Punët	
		LKP 2009	LKP 2016	LKP 2009	LKP 2016	LKP 2009	LKP 2016	LKP 2009	LKP 2016
1	Manaxherë	3	4	10	11	31	36	236	407
2	Specialistë me arsim të lartë	6	6	25	27	87	97	886	1281
3	Teknikë dhe specialistë në	5	5	20	20	81	89	681	1020

	zbatim								
4	Nëpunës	2	4	7	8	24	29	142	195
5	Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve	2	4	12	13	36	42	177	241
6	Punonjës të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit	3	3	9	9	22	22	185	191
7	Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to	5	5	15	14	72	76	939	1102
8	Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	3	3	13	14	41	45	673	772
9	Punëtorë (Profesione elementare)	6	6	11	11	28	33	182	244
0	Forcat e armatosura	2	3	3	6	13	11	124	36
Totali		37	43	125	133	435	480	4225	5489

Drafti përfundimtar i LKP së rishikuar është aprovuar në Komisionin Kombëtar të Nomenklaturave në INSTAT në shtator të këtij viti, dhe është përcjellë në MMSR se bashku me relacionin dhe një projekt VKM për miratimin e LKP-së.

II. VEPRIMTARI LIDHUR ME KUALIFIKIMET PROFESIONALE

II.1. Draft lista kombëtare e kualifikimeve profesionale

Me mbështetjen e KulturKontakt Austria u zhvillua një studim për identifikimin e nevojave për kualifikime profesionale të cilat duhet të popullojnë nivelet e KSHK-së në sektorin e mikpritjes dhe turizmit. Gjetjet nga rishikimi i studimeve për kërkesën për kualifikime profesionale në këtë sektor, kanë marrë në konsideratë prioritetet rajonale e kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe tendencat në punësim të vendit, si dhe trendet ndërkombëtare të zhvillimit të këtij sektori, u përpunuan dhe u propozuan masa për rishikimin e kualifikimeve profesionale që duhet të ofrohen në sektorin e mikpritjes qoftë në emërtime, qoftë në përmbajtjen e atyre ekzistuese.

Tabela 1. Rishikimi i kualifikimeve profesionale në drejtimin hoteleri-Turizëm, të Listës Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale

KUALIFIKIMET PROFESIONALE	NIVELI KSHK	PROPOZIMI RISHIKIM/KUALIFIKIMI RI	STANDARDET E PROFESIONEVE
Hoteleri-turizëm	2	Rishikim	Punonjës ndihmës në hoteleri-turizëm
Bar Restorant	3	Rishikim	Kamerier Banakier
Guidë turistike	3	Rishikim	Udhërrëfyes dhe animator turistik
Shërbime udhëtimi	3	I ri	Agjent i shërbimeve të udhëtimit
Shërbime restoranti dhe hoteli	3	I ri	Punonjës shërbimesh në hotel dhe restorant
Manaxhim restoranti dhe hoteli	5	I ri	Manaxher në restorant Manaxher në hotele
Zhvillimi i produkteve turistike	5	I ri	Zhvillues i produktit turistik
Organizim eventesh	5	I ri	Specialist eventesh (Bankete, shërbime katering,...)

Gjetjet e këtij studimi do të shërbejnë për të hartuar standardet e profesionale si bazë për zhvillimin e kualifikimeve profesionale të reja dhe/ apo për të rishikuar ato ekzistuese në përputhje edhe me përshkruesit e niveleve të KSHK.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, janë zhvilluar vizita në shkollat profesionale në Durrës, Elbasan Gjirokastër, Sarandë, Lezhë, Kukës, Peshkopi, Rubik, Bulqizë, Fier, Berat, Lushnjë për të

marrë sugjerime për listën e kualifikimeve, por edhe për të orientuar shkollat në zgjedhjen e kualifikimeve sipas kërkesave të tregut lokal/rajonat të punës.

Me mbështetjen e ETF-së, është në proces hartimi një inventari i kualifikimeve profesionale dhe i analizës së kualifikimeve. Inventari i kualifikimeve përfshin 10 tipe kualifikimesh që ofrohen në nivelet 2-8 të KSHK-së. Ky inventar përfshin 363 kualifikime të ofruara në mbi 19 fusha të ndryshme profesionale, dhe siguron informacione të rëndësishme lidhur me aspekte të llojit të kualifikimit, rrugëve të progresit në KSHK, procedurave të sigurimit të cilësisë për futjen e kualifikimeve profesionale në KSHK, aspekte të zhvillimit të standardeve të kualifikimeve profesionale, etj.

II.2. Përshkrimet të kualifikimeve profesionale

Gjatë këtij viti, janë hartuar 30 përshkrime të kualifikimeve profesionale në terma të rezultateve të të nxëniet në njohuri, shprehje profesionale dhe kompetenca të përgjithshme në 15 fushat profesionale, për nivelet 2,3 dhe 4 të KSHK-së. Në këtë proces janë angazhuar mbi 120 bashkëpunëtorë duke përfshirë përfaqësues të bizneseve të ndryshme, por edhe mësues të shkollave profesionale. Lista e detajuar e përshkrimeve të kualifikimeve profesionale është në aneksin II.

Me mbështetjen e projektit Al-Tour, të zbatuar nga KulturKontakt, ka filluar procesi i hartimit të standardeve të 2 profesioneve, “Punonjës ndihmës në hoteleri-turizëm” dhe “Kamarier - banakier”, sipas një metodologjie të zbatuar për këtë qëllim, me pjesëmarrjen e më së shumti të ekspertëve të profesionit në sektorin privat, por edhe me përfaqësues të shkollave profesionale.

III. VEPRIMTARI NË KUADRIN E TASK FORCËS PËR KSHK DHE ANËTARËSIMIT NË GRUPIN KËSHILLIMOR TË KORNIZËS EVROPIANE TË KUALIFIKIMEVE (KEK)

Në kuadrin e veprimtarisë së Task Forcës për KSHK, është kontribuar në të gjitha takimet e zhvilluara gjatë këtij viti, me prezantime, informacione, komente dhe sugjerime për çështje të ndryshme që lidhen me KSHK. Është kontribuar me mendime dhe sugjerime për hartimin e manualit për KSHK dhe broshurës përkatëse të KSHK.

Në mbështetje të planit të veprimit të Task Forcës për KSHK, në bashkëpunim me partnerët socialë është analizuar ligji ekzistues për KSHK, janë konsultuar modele të ligjeve të ngjashme në vende të tjera, dhe është konceptuar drafti i ligjit të amenduar për KSHK, i cili është përcjellë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe për arsimin dhe formimin profesional.

Me mbështetjen e ETF, është organizuar takimi orientues për referencimin e KSHK me KEK, si dhe është kontribuar në hartimin e një Udhërrëfyesi për fillimin e procesit të referencimit të KSHK me KEK në Shqipëri.

Në kuadrin e përfaqësimit në Grupin Këshillimor të KEK është marrë pjesë në dy prej takimeve të zhvilluara, ku qëllimi kryesor është procesi referencimit të kornizave kombëtare me atë evropiane për të rritur transparencën në sistemet e kualifikimeve dhe mobilitetin në tregun e punës.

IV. VEPRIMTARI NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTIT “SKEMAT E ÇIRAKËRISË PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE NË SHQIPËRI”, FINANCIAR NGA ERASMUS +, SI DHE TË PROJEKTIT PËR “PLATFORMËN ELEKTRONIKE TË TË NXËNIT TË TË RRRITURVE” (EPALE)

Në mbështetje të planit të veprimtarive në kuadër të zbatimit të projektit “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”, financiar nga ERASMUS +, janë hartuar standardet për 2 profesione respektivisht “Kuzhinier dhe pasticier” dhe “Receptionist”. Bazuar në informacionin e këtyre standardeve të profesioneve, si dhe në përputhje me përshkruesit e nivelit III të KSHK, u rishikuan përshkrimet e kualifikimeve profesionale: “Kuzhinë-Pastiçeri” dhe “Reception”, niveli III në KSHK. Gjithashtu është kontribuar në takimin 2 ditor për “Promovimin e praktikave më të mira të të nxënimit në vendin e punës” organizuar nga AKAFPK dhe Instituti i Hamburgut për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.

Në kuadrin e projektit EPALE, është kontribuar në organizimin e takimit hapës të Projektit EPALE, si dhe në hartimin e termave të referencës dhe vlerësimin e kandidatëve për ekspertë në kuadrin e projektit. Gjithashtu, është kontribuar për koordinimin e takimeve të organizuara në Shkodër, Vlorë dhe Elbasan për promovimin e platformës EPALE

V. BASHKËPUNIM ME MMSR DHE INSTITUCIONE TË TJERA

Në kuadrin e hartimit të Projekt-ligjit për AFP-në, është kontribuar me komente dhe sugjerime në takimin 2 ditor të organizuar për këtë qëllim në Berat. Është asistuar në panairin dhe olimpiadën e aftësive të organizuar për promovimin e AFP-së, si dhe është kontribuar me prezantim në konferencën për “Listën Kombëtare të Profesioneve” në kuadrin e këtij eventit. Gjithashtu, është dhënë kontribut për plotësimin e fishave për raport progresin SKAP 2014-2020.

Në kuadrin e mbështetjes, për DRFPP-të, janë zhvilluar vizita në qendrat e formimit profesional në Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Fier, Nr. 1 dhe 4 në Tiranë, për hartimin e listës së kurseve unike të formimit profesional.

Në kuadrin e bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe të Sporteve (MAS) është kontribuar në grupin e përbashkët të punës me MAS për strukturën e kulturës së përgjithshme në arsim profesional, si dhe është dhënë kontribut në monitorimin e procesit të maturës shtetërore 2016.

Përfaqësues të sektorit kanë marrë pjesë në takime të ndryshme të organizuara nga institucione të ndryshme, të tilla si:

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në MZHETTS në kuadër të hartimit të Task Plan.
- Pjesëmarrje në takimin e grupit të punës në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës rreth procesit të trajnimit dhe certifikimit të punonjësve të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve.
- Pjesëmarrje në takimin për profesionet e rregulluara organizuar nga MAS, me mbështetjen e TAIEX
- Pjesëmarrje në takimin për “Smart Specialization and Innovation” organizuar nga MAS, me mbështetjen e TAIEX.

VI. KONTRIBUTE NË KUADRIN E ZHVILLIMIT TË BASHKËPUNIMIT ME AGJENCI HOMOLOGUE DHE ME PROJEKTE TË TJERA

Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale ka kontribuar me prezantime në Takimin e Grupeve Teknike në kuadër të programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” (2014-2018) për komponentët: “Mjedis dhe kuadër rregullator i përmirësuar i skemave të të nxënimit nëpërmjet punës” & “Sigurimi i Cilësisë dhe Akreditimi i Ofruesve të AFP-së”, si dhe për komponentin: “Parashikimi i aftësive për kualifikime profesionale”.

Gjatë këtij viti është kontribuar me prezantime në takimin e ndërkombëtar “Validimi i të nxënimit informal dhe joformal”, organizuar në Ankara, si dhe në takimin e organizuar nga Aleanca Evropiane për ‘Të nxënimit në vendin e punës’, në Kayseri/Turqi.

Me mbështetjen e ETF-së, është marrë pjesë dhe është kontribuar me prezantime dhe raportime në takimin e ndërkombëtar “Promovimi i kornizave të kualifikimeve”, organizuar në Kiev, si dhe në konferencën ndërkombëtare për zhvillimin e sistemeve të kualifikimeve “Getting organized”, organizuar në Bruksel.

Gjatë këtij viti, janë organizuar takime të përbashkëta me përfaqësues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve Kosovë për krijimin e urave të bashkëpunimit në drejtimin të zhvillimit të kornizave kombëtare të kualifikimeve, si dhe u mor pjesë në Konferencën Kombëtare të organizuar për referencimin e Kornizës Kombëtare të Kosovës me KEK.

Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Vjenë, si dhe në takimin e Rrjetit të Agjencive të AFP në vendet e Evropës Jug-Lindore duke patur si qëllim nxitjen e bashkëpunimit në rajon për të nxënëin në vendin e punës.

Në dhjetor, u mor pjesë në takimin e parë rajonal “Skills Shoë: Sarajevo 2016”, qëllimi i të cilit ishte promovimi arsimit dhe formimit profesional, mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit të arsimit dhe biznesit, si dhe konkursi i aftësive ndërmjet nxënësve.

VEPRIMTARITË E SEKTORIT TË SKELETKURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË TRAJNIMIT TË MËSUESVE

Gjatë vitit 2016, veprimtaria e Sektorit të Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP (SSTM) është mbështetur në Planin e punës së AKAFPK, në Planin e punës dhe objektivat e Sektorit, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Fokusi i Sektorit ka qënë jo vetëm përmbushja e objektivave për aspektet sasore të produkteve të planifikuara, por edhe garantimi i cilësisë së proceseve dhe produkteve përkatëse.

Përgjithësisht, Sektori i SSTM i ka përmbushur me sukses objektivat e planifikuara ose të rishikuara sipas situatave dhe mundësive konkrete, pavarësisht nga largimi i një prej specialistëve të sektorit (ende i pazëvendësuar). Kjo edhe si rezultat i të qenit aktiv nga secili antar i sektorit, i punës në grup, i bashkëpunimit me sektorët e tjerë të Agjencisë, me MMSR dhe institucione të tjera, me Shkollat Profesionale dhe DRFPP-të, me partnerët socialë, me donatorët etj. Shkëmbimi i përvojave dhe vullneti për të ngritur në mënyrë të vazhdueshme nivelin profesional të anëtarëve të Sektorit ka ndikuar gjithashtu pozitivisht në përmbushjen e detyrave.

VII. KONTRIBUTET E SEKTORIT TË SSTM

Në zbatim të funksioneve të tij, Sektori i SSTM, gjatë vitit 2016, ka kontribuar nëpërmjet kryerjes së një tërësie procesesh dhe realizimit të disa produkteve kryesore që kanë mbështetur zhvillimin e AFP si në nivel qendror, ashtu edhe në nivelin e ofruesve (shkollave profesionale dhe qendrave të formimit profesional).

Më poshtë renditen kontributet kryesore të sektorit, të ndara sipas fushave të veprimtarisë.

VII.1 Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit kurrikular për AFP dhe mbështetja e zbatimit të tij.

Përgatitja e dokumentacionit kurrikular (skeletkurrikula, programe kursesh të shkurtra, materiale mësimore mbështetëse) përbën vëllimin më të madh të punës së sektorit të SSTM. Moderimi i hartimit të dokumentacionit të ri kurrikular është bërë në përputhje me metodologjinë dhe formatet e miratuara, mbështetur edhe në dokumentet përkatëse të përgatitura nga Sektori i SPKP (përshkrime të profesioneve dhe përshkrime të kualifikimeve). Garanci për cilësinë e tyre ka qënë edhe përvoja e dhjetëra individëve dhe grupeve të punës me specialistë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe të biznesit, të përzgjedhur me kujdes nëpërmjet procedurave zyrtare të AKAFPK.

Gjatë vitit 2016, Sektori i SSTM ka moderuar procesin e *hartimit të 15 skeletkurrikulave të reja* të kualifikimeve profesionale në tre nivele të KSHK.

Në kuadrin e ndryshimeve në kornizën e re kurrikulare të arsimit të mesëm të përgjithshëm, Sektori ka kontribuar në përgatitjen e ndryshimeve në kulturën e përgjithshme të AP, si dhe ka bërë korigjimet e duhura në planin mësimor (për kl.10) në të gjitha kualifikimet profesionale të nivelit të parë të Arsimit Profesional.

Sektori ka mbikëqyrur ecurinë e zbatimit të skeletkurrikulave që janë në zbatim dhe nisur nga informacionet e marra nga takimet me drejtues, mësues dhe instruktorë të rreth 30 shkollave profesionale, ka drejtuar procesin e *rishikimit dhe përmirësimit të 6 skeletkurrikulave* për vitet shkollore 2016-17 dhe 2017-18.

Për të mbështetur mësuesit e lëndëve profesionale dhe nxënësit në AP, nisur edhe nga fakti që në AP ka mungesa të theksuara të teksteve mësimore, Sektori (në konsultim edhe me BOTEM) ka përcaktuar nevojat më emergjente dhe ka moderuar procesin e hartimit të *13 materialeve mësimore mbështetëse* të lëndëve profesionale.

Përsa i përket *programeve të kurseve të formimit profesional*, Sektori i SSTM ka përgatitur dhe ka dërguar për miratim në MMSR, Propozimin “Për një model unik të programeve të kurseve të shkurtra të formimit profesional publik në Shqipëri”, i cili parashtron si formatin, ashtu edhe metodologjinë e hartimit të këtyre programeve, si përgjegjësi e AKAFPK. Në bashkëpunim me Sektorin e SPKP, është hartuar edhe një listë e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik. Vonesa në miratimin e Propozimit për kurset e unifikuara dhe e listës përkatëse, si dhe në daljen e Udhëzimit përkatës, e ka penguar Sektorin e SSTM të angazhohet intensivisht në hartimin e programeve të kurseve të shkurtra të formimit profesional. Sidoqoftë, në bashkëpunim me agjencinë Austriake “ADA”, Sektori ka kontribuar në *hartimin e 2 programeve të kurseve të shkurtra* në fushën e Turizmit.

VII.2 Trajnimi dhe udhëzimi i mësuesve dhe drejtuesve në AFP

Gjatë vitit 2016, Sektori i SSTM ka mbikëqyrur zbatimin e produkteve kurrikulare në SHP-të dhe DRFPP-të, si dhe ka udhëzuar e këshilluar drejtuesit dhe mësuesit/instruktorët në lidhje me to. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave në rreth 30 SHP dhe 10 DRFPP), ashtu edhe nëpërmjet komunikimeve në distancë (e-mail, biseda telefonike).

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2016-17, Sektori përgatiti dhe publikoi një “Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale”.

Përsa i përket mbështetjes së mësimdhënësve të AFP për aspektet didaktike, specialistët e Sektorit, në takimet dhe vëzhgimet e kryera në SHP-të dhe DRFPP-të, kanë marrë të dhëna për gjendjen e mësimdhënësve dhe kanë ofruar mbështetjen e tyre për aspekte të ndryshme didaktike. Sektori ka bërë propozime konkrete për ndryshimet e nevojshme në sistemin e zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve në AFP, duke qenë pjesë aktive e pilotimit të “njësive të trajnimit në ofruesit e AFP”, në kuadrin e “projektit të demonstrimit” të mbështetur nga Fondacioni European i Trajnimit (ETF).

Gjatë vitit 2016, Sektori është angazhuar në zbatimin e Programit të trajnimit 24 ditor për “Bazat e didaktikës në AFP”, të mbështetur nga GIZ dhe të pilotuar për një grup prej 24 mësimdhënësisht të AFP. Antarë të Sektorit kanë kontribuar drejtpërdrejt jo vetëm në finalizimin e Programit të këtij trajnimi dhe hartimin e Manualit përkatës, por edhe në realizimin e trajnimit në rolin e “trajnerëve të mësuesve”.

Anëtar e Sektorit të SSTM janë angazhuar edhe si trajnerë në moderimin e seancave të trajnimeve për dhjetra mësues, instruktorë dhe drejtues në AFP, të mbështetura nga GIZ apo organizata të tjera.

Spektori ka kontribuar edhe në strukturimin e një “banke të dhënash” dixhitale për mësimdhënësit e AFP publik në Shqipëri (mbështetur nga GIZ).

Në bashkëpunim me IZHA, Spektori ka mbështetur edhe në hartimin e Programit kombëtar të kualifikimit dhe të testeve për atestimin e mësuesve të AP.

VII.3 Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve

Një pjesë e ndjeshme e kohës së punës së Sektorit të SSTM i është kushtuar veprimtarive të ndryshme në kuadrin e porosive të MMSR dhe të bashkëpunimeve me institucione dhe aktorë të shumtë që veprojnë për aspekte të ndryshme të AFP. Të tilla veprimtari janë:

- Pjesëmarrje në procesin e rishikimit të kuadrit ligjor të AFP, te drafti i Ligjit të ri të AFP (kryesisht për aspektet e strukturës së arsimit profesional, të funksioneve të AKAFPK dhe të sistemit të kualifikimit të mësimdhënësve), si dhe në hartimin e akteve nënligjore (për disa udhëzime të MMSR dhe MAS). Kontribute edhe për draftin e Ligjit për Zejtarinë. Këto kontribute janë dhënë nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës përkatëse ose në formën e komenteve me shkrim.
- Në kuadrin e bashkëpunimit të brendshëm të AKAFPK, janë organizuar takime për diskutimin e propozimeve për modelin e Programeve të kurseve të unifikuara dhe të Listës së kurseve të unifikuara, si dhe janë bërë komente për dokumente të ndryshme të Drejtorisë apo të sektorëve të tjerë të AKAFPK.
- Pjesëmarrje në Komisionin e përzgjedhjes së anëtarëve të grupeve të punës për produktet e AKAFPK dhe në Komisionin e transferimit të nxënësve në AP.
- Pjesëmarrje në Komitetin e Maturës Shtetërore për aspekte të Maturës Shtetërore Profesionale.
- Pjesëmarrje si monitorues dhe korrigjues në Provimet e Maturës Shtetërore.
- Pjesëmarrje në Komisionin për specifikimet teknike të Laboratorëve të shkollave profesionale (kërkesë e MMSR)
- Kontribute në organizimin, përgatitjen e testeve dhe realizimin e Olimpiadës dhe Konkursit të Aftësive për vitin 2016 (në City Park)
- Përgatitja e rekomandimeve për BOTEM në lidhje me titujt dhe tirazhet e teksteve mësimore të AP, bazuar në një analizë të nevojave për to.
- Janë bërë komente për Udhëzimin për Maturën Shtetërore Profesionale 2016.
- Janë dhënë kontribute për draftin e Strukturës së AP
- Janë plotësuar tabelat për Strategjinë AFP
- Janë bërë komente për një Informacion për mbylljen e vitit shkollor.
- Është bërë përpunimi i të dhënave statistikore mbi numrin e nxënësve të AP
- Janë bërë komente për Urdhërin për fillimin e vitit shkollor 2016-17 (kërkesë nga MAS)
- Kontribute në grupin e punës për hartimin e Kulturës së përgjithshme të AP (në bashkëpunim me IZHA).
- Përgatitja e draft-buxhetit të Sektorit SSTM në kuadrin e NESS (kërkesë e MMSR)

- Pjesëmarrje në takim pune në MMSR për analizën e drejtimit Gjeologji-miniera (Bulqizë).
- Pjesëmarrje në Takimin e Grupit Tematik “Mundësia për Punësim, Punësimi dhe Aftësitë e Punësimit” (MMSR).
- Eshtë bërë një takim në SHKP për të diskutuar mbi listën e kurseve të unifikuara të FPP
- Është bashkëpunuar me Sektorin e PKP për përgatitjen e Listës së kurseve të shkurtëra të unifikuara.
- Është përgatitur plani i buxhetit të SSSTM
- Janë bërë komente për Programin e Atestimit të mësuesve të AP për 2016 (përgatitur nga IZHA)
- Kontribute në kryerjen e procedurave të prokurimit elektronik për “Blerje materiale kancelari” për nevojat e Autoritetit Kontraktues (AKAFPK).
- Takime në MMSR në lidhje me rritjen e cilësisë së AP.
- Takim në MMSR për kontributin e KfW në AFP
- Takime për Qendrën Multifunksionale në Elbasan, në kuadrin Task-Forcës përkatëse.
- Pjesëmarrje dhe kontribute në përrurimin e shkollës “Kolin Gjoka” të Lezhës dhe konkursin e kuzhinës.
- Pjesëmarrje dhe kontribute në trajnimin mësuesve të arsimit bujqësor në shkollën bujqësore Cërik, organizuar nga Ambasada Italiane në Shqipëri.

VII.4 Veprimtari në kuadrin e angazhimit në Projekte të AKAFPK-së

Spektori i SSTM është angazhuar në Projektet e AKAFPK, posaçërisht në Projektin “Skemat e çirakërisë për punësimin e të rinjve në Shqipëri” në partneritet me HIBB (financuar nga ERASMUS+) dhe Projektin “EPALE”.

Në lidhje me Projektin e financuar nga **ERASMUS+**, më hollësisht, veprimtaritë në të cilat është angazhuar Spektori janë:

- Kontribute për përgatitjen e Termave të Referencës për konsulencat dhe në Komisionet e prokurimit të konsulencës dhe blerjeve.
- Kontribute në planifikimin dhe organizimin e veprimtarive të Projektit.
- Kontribute të drejtpërdrejta në hartimin e skeletkurrikulave pilot “Reception”, niv. II dhe “Kuzhinë pastiçeri”, Niv. II.
- Pjesëmarrje, prezantime për përvojat e të nxëniet në punë dhe diskutime në ëorkshopet dhe takimet e organizuara në Tiranë, në bashkëpunim me HIBB.
- Pjesëmarrje në 3 Seminare 1-ditore në kuadër të Projektit “Skemat e Praktikës për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri“, pjesë e programit.
- Pjesëmarrje në takime dhe konsulta me konsulentët lokalë/ndërkombëtarë të Projektit.
- Komente për raportet e konsulentëve lokalë/ndërkombëtarë të Projektit.
- Kontribute në kuadrin e komisionit për prokurimet (Erasmus+).

Ndërsa në lidhje me Projektin “**EPALE**”, veprimtaritë kryesore të Sektorit janë:

- Kontribute për përgatitjen e Termave të Referencës për konsulencat.
- Kontribute në planifikimin dhe organizimin e veprimtarive të Projektit
- Kontribute në organizimin dhe realizimin e Kick off të Projektit EPALE.
- Ndjekja e ëebinar-eve të EPALE.

- Organizimi dhe realizimi i 4 takimeve rajonale në Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Korçë për promovimin e platformës EPALE.
- Organizimi i forumit të diskutimit mbi “Të nxënit e të rriturve në Shqipëri”, në bashkëpunim me ETF.
- Pjesëmarrje dhe prezantim mbi EPALE në forumin e organizuar mbi të nxënit e të rriturve në Shqipëri.
- Përgatitja e prezantimit “Promovimi i EPALE në Shqipëri” në zbatim të takimeve rajonale për promovimin e platformës EPALE.
- Kontribute në përgatitjen e Propozimit për “Platformën elektronike për të nxënit e të rriturve në Europë” (EPALE).
- Kontribute në kuadrin e komisionit për prokurimet (EPALE).
- Fidbek në përkthimin e materialeve në kuadër të veprimtarive të projektit EPALE.

VII.5 Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimit me donatorët dhe institucionet ndërkombëtare, si dhe në veprimtari kombëtare/ndërkombëtare për AFP

Sektori i SSTM është angazhuar dhe ka dhënë kontribute në shumë veprimtari të kryera në bashkëpunim me projektet e donatorëve dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare që janë partnerë të rëndësishëm në zhvillimin e AFP në Shqipëri. Më poshtë renditen veprimtaritë kryesore që lidhen me këtë bashkëpunim:

- Pjesëmarrje dhe prezantime në ëorkshopet e organizuara nga MMSR dhe IPA apo ETF në lidhje aspekte të ndryshme të rishikimit të Ligjit të AFP.
- Kontribute për finalizimin e Programit 24 ditor të Trajnimit Didaktik të Mësuesve/Instruktorëve të AFP dhe përgatitjen e Manualit përkatës (mbështetur nga GIZ).
- Pjesëmarrje dhe kontribute në takimet dhe trajnimet e organizuara nga GIZ në lidhje me pilotimin e Programit të trajnimit të mësuesve/instruktorëve “Bazat e didaktikës në AFP”.
- Kontribute në trajnimet për drejtues dhe financierë të ofruesve të AFP (organizuar nga GIZ).
- Takime dhe shkëmbime përvojë me përfaqësues të Agjencisë për Arsim, Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, të Kosovës.
- Pjesëmarrje dhe kontribute në Konferencën “Formimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve”, organizuar nga IZHA
- Pjesëmarrje në Simpoziumin Kombëtar për AFP, në Tiranë.
- Pjesëmarrje në takimet për “Mjedis dhe kuadër rregullator i përmirësuar për përshkallëzimin e skemave të të nxënit nëpërmjet punës”, të organizuar nga UNDP.
- Komente për draftin e fishës dhe të SËOT për “Garantimin e cilësisë” në AFP në Shqipëri (ETF).
- Pjesëmarrje dhe kontribute në Ëorkshop-in 3-ditor mbi “Validimi i të nxënit joformal dhe informal” i zhvilluar në Ankara, Turqi

- Pjesëmarrje në panairin “DIDACTA 2016”, në Këln, Gjermani.
- Pjesëmarrje në takimin startues të Projektit “Skills for Jobs” (Sëisscontact).
- Pjesëmarrje dhe kontribute në Ëorkshopin e hapjes së Programit IPA 2013
- Ndjekja e video-konferencës “Ëork-based learning”, projekt pilot nga Slovakia e Serbia për bashkëpunimin midis punëdhënësve e ofruesve të AFP
- Pjesëmarrje në takimin për vlerësimin e projekteve të GIZ.
- Komente për “Factsheet on ËBL” (ETF).
- Komente për draftin e “Udhëzuesit për vetvlerësimin dhe akreditimin e ofruesve të AFP” (në bashkëpunim me UNDP).
- Pjesëmarrje në takime në kuadrin e Projektit “Economic and Social Empoëerment for Roma and Egyptians - a Booster for Social Inclusion”.
- Takime në Elbasan për fillimin e IPA 2013.
- Takime në Durrës në ëorkshopin “Procesi i referencimit të KEK në Shqipëri”
- Takim me përfaqësues të ETF për aspekte të ndryshme të AFP
- Pjesëmarrje dhe diskutime në takimin e rrjetit të SEE VET për “Identifikimin e prioriteteve për një projekt rajonal të përbashkët mbi të nxënit bazuar në punë (ËBL)”, organizuar nga ERI SEE në Beograd, Serbi.
- Pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare për AFP “Edukimi për njohuri dhe aftësi praktike”, organizuar nga GIZ në Beograd, Serbi.
- Pjesëmarrje në vizitë studimore për Modernizimin e AFP në drejtimin mësimor “Bujqësi” (veçanërisht në “Frutari” dhe “Kopshtari”), me mbështetjen e GIZ, në Gjermani.
- Pjesëmarrje në takimin e parë rajonal “Skills Shoë: Sarajevo 2016”, organizuar nga disa institucione ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje në “Entrepreneurial Camp”, organizuar nga SEECCEL në Shibenik, Kroaci
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Universiteti Polis për efiç iencën e energjisë, në Tiranë.
- Pjesëmarrje dhe diskutime në takimin “Fuqizimi i AFP dhe përfshirja e biznesit në AFP”, oganizuar në MMSR dhe Këshilli Britanik, në Tiranë.

VII.6 Veprimtari të tjera

Sektori i SSTM gjatë vitit 2016 ka kryer edhe veprimtari të tjera që lidhen me:

- Përgatitjen e dokumentacionit zyrtar që ka të bëjë me veprimtarinë dhe produktet e Sektorit (raporte mujore dhe vjetore, plane mujore dhe vjetore, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, planifikimi i buxhetit të sektorit, dokumentacioni financiar, vlerësimi i stafit, materialet për publikime në faqe interneti etj.).
- Pjesëmarrjen në komisionin e AKAFPK për prokurimet e blerjeve.
- Kontribute në rifreskimin me informacione të faqes së internetit të AKAFPK.
- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Sektorit të SSTM. Kjo është kryer nëpërmjet studimit individual, shkëmbimit të përvojës, pjesëmarrjes në vizita studimore dhe në

veprimtari trajnimi, ndjekjes së kualifikimeve formale (një anëtar i Sektorit ka fituar diplomën e doktoraturës) etj.

- Pjesëmarrje në trajnim mbi prokurimet publike organizuar nga ASPA

Një përmbledhje e produkteve kryesore të Sektorit të SSTM, të realizuara gjatë vitit 2016, tregohet në Aneksin III të raportit (shih më poshtë).

VEPRIMTARITË E SEKTORIT TË VLERËSIM- CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE DHE AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË

Përgjatë vitit 2016, Sektori i Vlerësim-certifikimit të nxënësve dhe Akreditimit të ofruesve të AFP-së (SVCA), për realizimin e veprimtarive të veta, është mbështetur në objektivat vjetore të kësaj njësie organizative, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Sektori është fokusuar në dy drejtime kryesore: a) zhvillimi i kriterëve dhe standardeve të vlerësimit të nxënësve; b) Sigurimi i Cilësisë. Realizimi i të gjitha objektivave të Sektorit në kohë dhe me cilësi, ka ardhur si rezultat edhe i rritjes së shkallës së dedikimit, angazhimit dhe punës në ekip të stafit, bashkëpunimit me sektorët e tjerë të Agjencisë, bashkëpunimit ndërinstucional dhe me shkollat e qendrat e formimit profesional, si dhe me projektet e ndryshme. Si çdo vit, gjatë punës së tij, sektori konsultohet në vijimësi me dokumente të fushës së AFP-së si manuale, udhëzuesa dhe dokumente strategjike të ETF, SQA, OFSTED etj.

VIII. VEPRIMTARI PËR ZHVILLIMIN E KRITEREVE DHE STANDARDEVE TË VLERËSIMIT DHE CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE/KURSANTËVE

VIII.1 Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të niveleve

Në kuadër të planit vjetor të punës, gjatë vitit 2016 Sektori investoi kohë dhe shtoi përpjekjet për monitorimin e procesit të hartimit dhe rishikimit të 23 programeve orientuese për provimet përfundimtare të niveleve (Shih Aneksin V). Në lidhje me rishikimin, u hartua një format i ri dhe përmbajtje e re e pjesës praktike të programit orientues, me qëllim rritjen e nivelit të standardeve përkatëse të vlerësimit. Gjatë procesit të monitorimit, u kryen dy takime paraprake me të gjitha grupet e punës si dhe u hartua një udhëzues për të shpjeguar këtë format të ri dhe për t'i paraprirë procesit të rishikimit nga ana e tyre (grupeve).

Për hartimin e programeve të reja sektori mbledh informacion nga shkollat dhe burime të tjera (Portali i AFP-së), për drejtimet/profilet që ofrohen nga shkollat për identifikimin e nevojave përkatëse. Ndërkohë, për hartimin e programeve të reja orientuese të dy profileve

pilot të ERASMUS + (“Reception” dhe “Kuzhine e Pastiçeri”) u përshtat formati ekzitues i programit, në përputhje me strukturën dhe përmbajtjen e re të kurrikulave për këto dy profile të pilotuara. Ndryshimi ishte i domosdoshëm për shkak të përfshirjes në kurrikul të moduleve teoriko-praktike, një risi kjo e këtij procesi pilotimi.

VIII.1.1 Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale

U monitorua procesi i hartimit të një programi të ri për Maturën Shtetërore Profesionale, si dhe u plotësuan 26 programe orientuese të Maturës me referencat e bazës ligjore (Udhëzuesi i përbashkët MAS-MMSR dhe Rregullorja e Maturës Shtetërore 2016). (Shih Aneksin V)

VIII.1.2 Banka testesh

Një nga veprimtaritë e sektorit, në mbështetje të shkollave profesionale për ofrimin e kualifikimeve profesionale cilësore, është përgatitja e bankave me njësi testi (instrumente vlerësimi) për provimet përfundimtare, por edhe për vlerësimin e vazhduar të nxënësve. Përgjatë vitit 2016 u monitorua procesi i hartimit të 6 bankave me njësi testi (në total 1000 instrumente vlerësimi). (Shih Aneksin V). Shkollat janë orientuar t’i përdorin këto instrumente si gjatë vitit shkollor, ashtu edhe për hartimin e testeve të provimeve përfundimtare. Nga vizitat e kryera nëpër shkolla në qytetet Elbasan, Korçë, Vlorë, Fier dhe Shkodër për monitorimin e përdorimit të këtyre bankave rezultoi, se të gjitha shkollat i gjejnë një ndihmesë mjaft të vlefshme dhe i përdorin ato në vazhdimësi.

VIII.1.3 Certifikimi

Në fillim të vitit 2016 sektori, në bashkëpunim me Drejtorinë AFP-së pranë MMSR-së, rishikoi të gjitha dokumentet e certifikimit sipas niveleve. Njekohësisht, sektori hartoi dhe rishikoi listat e kompetencave profesionale (që pasqyrohen në certifikatat e niveleve) për 11 drejtime e profile mësimore.

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimit të modaliteteve të Maturës Shtetërore u rishikua certifikata e Maturës Shtetërore, që lëshohet nga shkollat profesionale për maturanët.

Në zbatim të Udhëzimit të MMSR-së “Për certifikimin e kurseve të formimit profesional” u hartua drafti i certifikatës së kurseve të unifikuara dhe u dërgua në MMSR për miratim.

Me kërkesë të MMSR-së, sektori përgatiti një informacion mbi dokumentacionin përmbyllës të vitit mësimor në shkollat profesionale, si dhe problematikën përkatëse.

VIII.1.4 Njehsim programesh studimi

Në bazë të Udhëzimit nr. 21, datë 09.07.2015 të MMSR dhe MAS, si dhe Rregullores përkatëse të AKAFPK-së një anëtar i Sektorit ka marrë pjesë në kryerjen e procedurave të

transferimit të nxënësve, që kanë kryer arsim profesional jashtë vendit. Procedurat kanë të bëjnë me shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit për transferim, njehsimin e lëndëve të kryera, identifikimin e lëndëve të munguara, konvertimin e rezultateve të vlerësimit dhe paraqitjen para komisionit përkatës të AKAFPK-së për miratim.

VIII.2 Sigurimi i Cilësisë

Në kuadër të Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” të UNDP-së dhe me mbështetjen e MMSR dhe AKAFPK janë realizuar këto veprimtari:

- Kontribut në grupin teknik të punës për “Sigurimin e cilësisë dhe Akreditimin e ofruesve të AFP-së”, pjesë e Programit.
- Takime me përfaqësues të UNDP-së për diskutimin e llojit të ekspertizës që mund të sigurojë projekti në fushën e sigurimit të cilësisë, hapat e procesit si dhe Termat e Referencës për hartimin e Udhëzuesit të Vetëvlerësimit të IoAFP-ve.
- Sektori dha kontribut në hartimin e pyetësorit mbi vetëvlerësimin për shkollat profesionale dhe qendrat e formimit publik.
- Sektori mori pjesë në realizimin e vizitave në shkolla në qytetet Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Lushnje dhe Berat për kryerjen e intervistave që lidheshin me çështjet e sigurimit të cilësisë, në bazë të pyetësorit të hartuar dhe përpunoi gjetjet.
- Sektori, në bashkëpunim me ekspertin e UNDP-së, përcaktoi fushat, nënfushat, treguesit dhe standardet e cilësisë, haroti kriteret për çdo tregues të përfshira të gjitha këto në draftin e Udhëzuesit të Vetëvlerësimit të IoAFP-ve. Ky udhëzues për institucionet ofruese të AFP-së hartohet për herë të parë dhe pasqyron të gjitha specifikat e ofertës mësimore të arsimit dhe formimit profesional. Drafti i Udhëzuesit, pas marrjes së feedback-ut nga përfaqësues të shkollave dhe qendrave të formimit dhe pasqyrimit të tij në dokument, u dërgua për miratim në MMSR.

VIII.3 Referencimi me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve

Me mbështetjen e ETF-së ka filluar procesi i referencimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Në këtë kuadër, një përfaqësues i sektorit ka marrë pjesë në:

- takimet e grupit teknik të Task Forcës për konsultimin dhe rishikimin e Manualit të KSHK-së;
- ëorkshop-et për grupin teknik të punës për fillimin e referencimit me KEK (EQF).

VIII.4 Veprimtari në kuadër të bashkëpunimeve

- **Në kuadër të bashkëpunimit me MMSR, janë kryer këto veprimtari:**
 - Në bashkëpunim me Drejtorinë e AFP-së, pranë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, u bë rishikimi dhe përpunimi i të gjithë dokumentacionit të certifikimit të

nxënësve në shkollat profesionale, për çdo nivel në veçanti, si dhe për Maturën Shtetërore Profesionale.

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Drejtoria e AFP-së pranë MMSR me përfaqësues të BALFIN Group, AKAFPK-së dhe të shkollës profesionale Bulqizë me tematikë mbarëvajtja e ecurisë së procesit mësimor të drejtimit “Gjeologji-Miniera.”
 - Përgatitja e një memoje në lidhje me ngarkesën mësimore të mësuesve të teorisë profesionale.
 - Shqyrtimi i formatit të ri të regjistrit të klasës për klasat e dhjeta.
 - Plotësimi i fishave të progres raportit për Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për masat që i takojnë AKAFPK-së.
 - Plotësimi i pyetësorit të KLSH-së mbi auditimin e performancës me temë “Shkollimi profesional në Shqipëri”, me fokus cilësinë në AFP.
 - Në kuadër të bashkëpunimit dhe forcimit të lidhjeve me partnerët socialë, ashtu si në vitet e kaluara, Sektori dha një kontribut sinjifikativ në procesin e bashkëpunimit me qendrën tregtare City Park, për organizimin, përgatitjen e detyrave vlerësuese dhe mbarëvajtjen e Olimpiadës së Aftësive Profesionale 2016, si dhe monitorimin e konkurrimit dhe pjesëmarrjen në grupet e vlerësimit.
- **Në kuadër të bashkëpunimit me MAS, janë kryer këto veprimtari:**
- Pjesëmarrje në Komitetin e Maturës Shtetërore 2016 dhe 2017.
 - Dhënia e kontributeve për hartimin e draftit të Rregullores së Maturës Shtetërore 2016 dhe 2017.
 - Përgatitja e informacionit të kërkuar nga AKP për të gjitha planet mësimore të drejttimeve/profileve të ofruara nga shkollat profesionale publike dhe jopublike, informacion ky që do të shërbente për platformën e re “Maturanti.”
 - Mbështetja e Agjencisë Kombëtare të Provimeve në koordinimin e grupeve të punës për hartimin e testeve të teorisë profesionale të Maturës 2016, për tre drejttime/profile të reja.
 - Në bashkëpunim me AKP-në, ndjekja e problematikës me nxënësit maturantë të shkollave profesionale, plotësimin e rubrikave të Certifikatës së Maturës Shtetërore Profesionale tek platforma “Maturanti.”
 - Pjesëmarrje në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2016, me kërkesë të MAS.
- **Në kuadër të bashkëpunimit me ETF-në, janë kryer këto veprimtari:**
- Është dhënë kontribut sinjifikativ në përgatitjen e analizës SËOT dhe rishikimin e fish raportit mbi “Sigurimin e Cilësisë në AFP në Shqipëri”, në kuadër të seminarit “Modernizimi i Sigurimit të Cilësisë në AFP – Qasje Evropiane”, i mbajtur me datat 1 dhe 2 Mars, Torino dhe i organizuar dhe mbështetur nga ETF.

- Përgatitja dhe pjesëmarrja në aktivitetin e Fokus Grupit dhe Të nxënit në palë, Vienë, për vendet e Rajonit të Europës Juglindore dhe Turqisë, në lidhje me mekanizmat e sigurimit të cilësisë, organizuar dhe mbështetur nga ETF.
- **Veprimtari në kuadër të projektit të GiZ:**
 - Me kërkesë të GiZ u bënë komente dhe u dhanë përgjigje në lidhje me pyetjet mbi praktikën me bazë punën – situata në Shqipëri.
 - Gjithashtu, janë dhënë komente dhe sugjerime për draftin e broshurës “Praktika profesionale: Udhëzues për kompanitë, nxënësit dhe ofruesit e AFP-së”, përgatitur nga GiZ. Pjesëmarrje në ëorkshop-in e organizuar me këtë fokus.
 - **Veprimtari në kuadër të projektit të Sëisscontact:**
 - Pjesëmarrje dhe kontribut në ëorkshop-in për lançimin e projektit “Aftësi për punë” (Skills for Jobs), organizuar dhe mbështetur nga Sëisscontact.
 - **Veprimtari të BIZNES ALBANIA:**
 - Pjesëmarrje në Konferencën e organizuar nga BIZNES ALBANIA me përfaqësues të Dhomës së Zejeve të Koblenzit (Gjermani) për fillimin e programit “Internshipi në kompani nga nxënësit e shkollave profesionale.”

VIII.5 Veprimtari në kuadër të projektit të USAID dhe SHUKALB:

Sektori ka dhënë kontribut në grupin e punës për Programin e Certifikimit bazuar në testim në sektorin e Ujësjellës-Kanalizimeve, program i cili mbështetet nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, USAID dhe SHUKALB.

Takimi me ekspertin Christopher McCord – Ekspert Certifikimi, SHBA shërbeu për diskutimin e kërkesave që duhet të plotësohen për çdo nivel të certifikimit të operatorit të kompanive të ujësjellës-kanalizimeve. Në vijim, përfaqësues i SVCA-së ka kontribuar gjatë shqyrtimit draftit të kornizës së punës për programin e certifikimit në vendin tonë, të operatorëve të sektorit Ujësjellës-Kanalizimeve.

VIII.6 Të tjera

Sektori është angazhuar edhe në disa veprimtari të tjera që lidhen ose jo drejtpërdrejt me përshkrimin e punës së tij:

- Sektori ka marrë pjesë në takimet e grupit të GMIP-së, nëngrupi Tematik “Mundësitë për Punësim dhe Aftësitë” ku janë prezantuar drafti i progres raportit për Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, indikatorët e mbështetjes buxhetore nga Komisioni Evropian

- Pjesëmarrje në Konferencën Ministrore mbi “Sistemin e Arsimit Profesional në Shqipëri lidhur me arritjen e prioriteteve të BE-së deri në vitin 2020 (Konkluzionet e Rigës)”, organizuar nga MMSR, AKAFPK dhe ETF.
- Pjesëmarrje në Konferencën e Guidave Turistike, organizuar nga Shoqata e Guidave Turistike, Shqipëri.
- Një anëtar i sektorit ka kryer proces trajnimi për prokurimet, pranë DAP-it.

VEPRIMTARITË E SEKTORIT TË ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

IX. KONTRIBUTET E SEKTORIT TË AF&TI

Sektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit në bashkëpunim me sektorët e tjerë ka realizuar objektivat sektoriale në përputhje me planin e aktiviteteve të institucionit për vitin 2016 si edhe detyra të tjera të paparashikuara për shkak të ndryshimeve në legjislacion, projekteve të fituara nga AKAFPK etj..

IX.1 Burimet njerëzore

Reforma e administratës publike dhe zbatimi i legjislacionit të ri për shërbimin civil është një nga përparësitë dhe sfidat kryesore për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në BE. Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni publik, qendror, përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore ka hartuar regjistrin elektronik HRMIS (Human Resources Management Information System), sistemin e menaxhimit të regjistrit të punonjësve të Administratës Publike. Sistemi lehtëson punën e përditshme duke ofruar dixhitalizimin e të dhënave të punonjësve. Në përputhje me udhëzimet periodike të Departamentit të Administratës Publike nëpunësi i AKAFPK-së, që merret me burimet njerëzore ka vazhduar punën me plotësimin e regjistrit HRMIS me të dhënat kryesore të punonjësve të AKAFPK-së.

Në mbështetje të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucioneve të tjera Publike, në mbështetje të VKM nr. 907, datë 11.11.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2015 në njësitë e qeverisjes qendrore” të ndryshuar, me të drejtë zgjatje të kontratës për vitin 2016, me urdhrin nr. 317, datë 27.11.2015 “Për detajimin e numrit të praktikantëve që do të punojnë me kontratë të përkohshme pune” është emëruar me kontratë 1-vjeçare me pagesë Znj. Jona Halili, si specialiste e kategorisë IVb e cila punoi pranë Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale të AKAFPK-së.

Ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare, shprehur në Programin e Qeverisë si edhe në dokumentet e tjerë strategjikë si Udhërrëfyese për 5 (pesë) prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian apo “Strategjia Ndër-sektoriale e Reformës në Administratën Publike

2015 – 2020, është rritja e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike me synimin e krijimit të një administrate profesionale për t'i bërë ballë sfidave të zhvillimit në Shqipëri. Për sa më sipër, në zbatim të detyrimeve ligjore, AKAFPK kanë paraqitur nevojat për trajnim të stafit në fushat e parashtruara nga DAP në bashkëpunim me ASPA. Duke e konsideruar procesin e formimit profesional të nëpunësve si një proces thelbësor në formimin e Administratës të aftë profesionale, sektori i AFTI i është përgjigjur kërkesave për trajnime nga MMSR dhe ASPA.

Kështu, mbështetur në kërkesat e AKAFPK-së për trajnime në bazë të temave të planifikuara nga ASPA janë trajnuar për vitin 2016 në sektorin e AFTI përkatësisht. Specialisti i Teknologjisë së Informacionit, nëpunës civil në periudhë prove, znj. Aida Tiko e cila e kaloi me sukses periudhën 1-vjeçare të provës duke marrë statusin e nëpunësit civil.

IX.2 Arkivat

Në bazë të ligjit nr. Nr.9154, datë 06.11.2003 “PËR ARKIVAT”, Rregullores mbi “Normat tekniko–profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” duke qenë se në organikën e AKAFPK-së nuk ka punonjës me detyrën e arkivit dhe protokollit, 2 nga punonjësit e sektorit të AF&TI krahas detyrave funksionale të tyre kryejnë protokollimin dhe arshivimin e dokumentacionit zyrtar. Lidhur me sa më sipër janë klasifikuar dokumentet e vitit 2016 dhe të vitit 2007 të AKAFPK-së për të vazhduar më pas me inventarizimin e tyre dhe përgatitjen për dorëzim në mars 2017, pranë Arkivës së Përgjithshme të Shtetit, si detyrim ligjor i AKAFPK-së.

Ky sektor, krahas punës periodike në administrimin e dokumentacionit zyrtar elektronik e fizik të AKAFPK-së, në përputhje me procedurat administrative të Institucionit si edhe legjislacionit aktual, ka kontribuar në hartimin e programit të transparencës së AKAFPK-së si edhe rifreskimin e vazhdueshëm të tij. Programi i transparencës përcakton kornizën e veprimtarisë së Agjencisë në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe është i pasqyruara në faqen zyrtare elektronike të AKAFPK-së, në adresën: <http://www.akafp.gov.al/rreth-nesh/programi>.

IX.3 Procedurat e transferimit të nxënësve në arsimin e mesëm profesional

AKAFPK, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 9.7.2015 “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz, në zbatim të “Rregullores së brendshme të AKAFPK-së për procedurat e transferimit të nxënësve shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri - procedura e njëvlershmërisë së studimeve të kryera” ka kryer njehsimin e programeve të ndjekura nga nxënësit shqiptarë ose të huaj që kanë shprehur kërkesat për transferimin e studimeve të tyre nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri. Komisioni ka shqyrtuar disa raste të cilëve u janë kthyer përgjigjet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IX.4 Faqja e internetit

AKAFPK përfaqësohet nga faqja elektronike zyrtare me adresë: www.akafp.gov.al. Në këtë faqe janë pasqyruar veprimtaritë kryesore të institucionit si edhe produktet e realizuara prej stafit të tij në fushën e arsimit dhe formimit profesional. Nëpërmjet këtij ëbsite lehtësisht të aksesueshëm, të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të AKAFPK-së,

legjislacionit shqiptar në fushën e AFP. Kjo faqe është aktive dhe përditësohet me veprimtari e njoftime të ndryshimet për t'i ardhur në ndihmë bashkëpunëtorëve shqiptarë apo të huaj, të interesuar në realizimin e produkteve në fushën e AFP. Në rritje të transparencës, është publikuar, gjithashtu, e gjithë mënyra e funksionimit të institucionit, financimit të tij, organizimit, struktura, adresa e institucionit, numrat e kontaktit si dhe adresa elektronike. Gjithashtu, në këtë faqe elektronike pasqyrohen veprimtaritë e dy projekteve të AKAFPK-së në kuadër të Programit “ERASMUS +. Sektori i AF&TI, veç rolit kryesor në përditësimin e ëbsite të AKAFPK-së, ka administruar dhe mirëmbajtur rrjetin kompjuterik të institucionit megjithëse, ky rrjet është i vjetruar.

IX.5 Zbatimi i projekteve në kuadër të programit Erasmus+

Në kuadër të projekti “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”, projekt i Programit “ERASMUS +”, për Arsimin, Trajnimin, Rininë dhe Sportin, sektori jonë ka kontribuar në mbështetjen e Njesisë së Zbatimit të Projektit në çështje të administrimit të dokumenteve, administrimin e adresave elektronike zyrtare, në ndjekjen e pagesave të prokurimeve të aktiviteteve të këtij projekti. Në ëeb-in zyrtar të AKAFPK-së është krijuar një “dritare elektronike” në të cilën pasqyrohen aktivitetet e këtij projekti në përputhje me planin e aktiviteteve të tij. Gjithashtu, nga specialistja e IT është projektuar, krijuar dhe plotësuar faqja zyrtare e projektit të lartpërmendur me adresë:

www.apprenticeshipyouthemployment.al. Kjo faqe është mirëmbajtur dhe rifreskuar me informacionet e projektit.

AKAFPK-ja është njësia koordinuese dhe përgjegjëse për zbatimin e Platformës Evropiane për Arsimin e të Rriturve (EPALE). Në kuadër të kësaj platforme AKAFPK ka zbatuar projektin EPALE NSS in Albania. Në këtë projekt, sektori i AF&TI ka dhënë kontributin e anëtarëve të tij në zbatim të objektivave të projektit dhe në përputhje me marrëveshjen e tij. Projekti do të shtrihet edhe për periudhën 2017- 2018. Veç kësaj, sektori ka kontribuar në hartimin e disa dokumenteve të nevojshme për në MMSR dhe Ministrinë e Financave (MF).


IX.6 Financa

Për vitin buxhetor 2016, AKAFPK filloi aktivitetet e saj në janar 2016 me një buxhet të përgjithshëm prej 36,500,000 lekë. Nga këto për zërin 602 AKAFPK kishte të miratuara në janar 2016, shumën 19,000,000 lekë dhe më pas të konfirmuara nga MMSR dhe dega e Thesarit të Shtetit 12,000,000 lekë. AKAFPK-ja ka realizuar aktivitetet e planifikuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MMSR dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2016

Artikulli	600 Shpenzime për paga	601 Sigurime shoqërore	602 Shpenzime operative TOTAL	231 Projekti “Skemat...”
Buxheti i miratuar në Janar 2016 në lekë	15,000,000	2,500,000	19,000,000	

Ndryshime gjatë vitit	-800,000	0	-7,000,000	7,500,000
Buxheti Gjithsej PLAN	14,200,000	2,500,000	12,000,000	7,500,000
Realizimi në 2016 FAKT	13,717,643	2,254,300	9,619,765	7,169,470
Buxheti i mbetur 2016 në lekë	482,357	245,700	412,969	330,530



Mbështetur në tabelën e mësipërme, buxheti i AKAFPK-së, i planifikuar në artikullin 602 është shpenzuar në total në masën 80%. Buxheti i AKAFPK-së, i planifikuar sipas aktiviteteve sektoriale është shpenzuar duke realizuar produktet si më poshtë:

- 30 kualifikime profesionale
- 4 përshkrime profesionale,
- 16 kurrikula,
- 6 rishikime kurrikulash,
- 13 materiale mësimore,
- 2 Prog kursesh te shkurtra
- 6 banka testesh,
- 10 programe të reja orientuese.

- 14 programesh orientuese të rishikuara.

Gjithashtu, gjatë vitit 2016, AKAFPK-ja ka vazhduar punën në zbatimin e projekteve të saj. Një nga projektet kryesore të saj është “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”, projekt i Programit “ERASMUS + (Projekti. N. 556911-EPP-1-2014-1-AL-EPPKA3-APPREN, marrëveshja N. 2014-3358 / 001-001, datë 02.12.2014. Data e përfundimit të tij 31.03.2017). Realizimet buxhetore të aktiviteteve të këtij projekti janë realizuar sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit në llogaritë Euro dhe Lek realizuar nga AKAFPK sipas planit të projektit “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri” për vitin 2016

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2016	Buxheti i transferuar gjatë vitit	Buxheti i realizuar	Buxheti i mbetur
Llogaria në Euro	4,426	-4,400		26
		Transferuar nga llogaria Euro në llogarinë në lekë		
Llogaria në Lek	827,452	607,200	1,408,490	26,162

Në kuadër të zbatimit të projektit “EPALE NSS in Albania” (Projekti “EPALE National Support Services”, Agreement number – 2015 – 3228/ 001 – 001, Project Number 568814-EPP-1-2015-1-AL-EPPKA2-EPALE-NSS), AKAFPK-ja ka realizuar aktivitetet e planifikuara të projektit në shumat sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “EPALE NSS in Albania” në llogaritë Euro dhe Lek, realizuar nga AKAFPK sipas planit të këtij projekti për vitin 2016

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2016	Buxheti i transferuar gjatë vitit	Buxheti i realizuar	Buxheti i mbetur
Llogaria në Euro	2,500		1,884	616
Llogaria në Lek	1,456,665		1,450,543	6,122

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e

Programit Buxhetor 2017 – 2019 sektorët e AKAFPK kanë bashkëpunuar në përgatitjen e tij.

IX.7 Të tjera

Mbështetur në Urdhrin e Ministrit të Arsimit “Për caktimin e përfaqësuesve të MAS dhe detyrat e tyre në provimet e Maturës Shtetërore 2016”, AKAFPK ngarkohej për zbatimin e tij. Kështu, AKAFPK është përfshirë në procesin e zhvillimit të Maturës Shtetërore 2016, në muajt maj-qershor të vitit 2016. Në këtë proces janë angazhuar pothuajse të gjithë anëtarët e stafit.

Si rezultat i punës së të gjithë stafit të AKAFPK-së, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre individual apo në grup është bërë e mundur të kryhen me përgjegjësi dhe profesionalizëm detyrat në përputhje më objektivat e AKAFPK-së për vitin 2016.

ANEKSE

ANEKSI I

PRODUKTE QË LIDHEN ME FUSHËN E PROFESIONEVE (Janar-Dhjetor 2016)

- 1. Drafti fillestar i rishikuar i LKP**
- 2. Lista Kombëtare e Profesioneve e rishikuar (përfundimtare)**
 - i. Lista Kombëtare e Profesioneve (vetëm titujt)**
 - ii. Lista Kombëtare e Profesioneve (titujt dhe përshkruesit e 666 profesioneve)**
- 3. Tabela Korresponduese e LKP e rishikuar 2016 - LKP 2009 - ISCO 2008**
- 4. Projekt-VKM, për “Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”**
- 5. Standardi profesionit “Kuzhinier-Pasticier”**
- 6. Standardi i profesionit “Receptionist”**

ANEKSI II

I. PRODUKTE QË LIDHEN ME FUSHËN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE (Janar-Dhjetor 2016)

- 1. Studimi për përafrimin e kualifikimeve profesionale në fushën e hoteleri-turizmit me nevojat e sektorit të mikpritjes në Shqipëri.**
- 2. Inventari i kualifikimeve profesionale**

II. LISTA E PËRSHKRIMEVE TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

- 1. Galanteri , niveli III, në KSHK**
- 2. Teknologji kimike, niveli IV, në KSHK**
- 3. Shërbime sociale-shëndetësore, niveli IV, në KSHK**
- 4. Gjeologji-miniera, niveli IV, në KSHK**
- 5. Markshajderi, niveli III, në KSHK**
- 6. Gjeologji, niveli III-të i KSHK**
- 7. Shërbime në mjetet e rënda të transportit, niveli III, në KSHK**
- 8. Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë, niveli II-të i KSHK**
- 9. Termohidraulikë, niveli II, në KSHK**
- 10. Punime dekorative dhe lyerje, niveli III në KSHK**
- 11. Mirëmbajtje ndërtesash, niveli III-të i KSHK**
- 12. Animim Social, niveli III-të i KSHK**
- 13. Shërbime bankare, niveli IV-të i KSHK**
- 14. Silvikulturë niveli, IV-të i KSHK**
- 15. Shpim për naftë, gaz dhe ujë, niveli III-të i KSHK**
- 16. Shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë, niveli III-të i KSHK**
- 17. Poligrafi, niveli II-të i KSHK**
- 18. Agrobiznes, niveli III-të i KSHK**
- 19. Shërbime kujdesi për kafshët, niveli III-të i KSHK**
- 20. Teknologjia e përpunimit të plastikës dhe gomës, niveli III-të i KSHK**

ANEKSI III Lista e produkteve të SSTM për vitin 2016

I. Skeletkurrikula të reja:

1. Për drejtimin “Shërbime kujdesi për të moshuar-pilot GIZ”, niv.III.
2. Për drejtimin “Teknologji kimike”, niv.III.
3. Për drejtimin “Gjeologji miniera”, niv.III.
4. Për drejtimin “Shpim, shfrytëzim, nxjerrje nafte gazi dhe uji”, niv.I.
5. Për profilin “Galanteri”, niv.II, në drejtimin “Tekstil konfeksione”.
6. Për profilin “Rrjete të dhënash-pilot GIZ”, niv.III, në drejtimin “TIK”.
7. Për profilin “Reception-pilot Erasmus”, niv II, në drejtimin “Hoteleri - turizëm”.
8. Për profilin “Kuzhinë pastiçeri-pilot Erasmus”, niv II, në drejtimin “Hoteleri - turizëm”.
9. Për profilin “Modelim”, niv. II, në drejtimin “Tekstil konfeksione”.
10. Për profilin “Teknologji e përpunimit të materialeve të ndërtimit”, niv. II, në drejtimin “Teknologji kimike”.
11. Për profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niv. II, në drejtimin “Ndërtim”.
12. Për profilin “Peshkim”, niv. II, në drejtimin “Peshkim”.
13. Për profilin “Tregti”, niv. III, në drejtimin “Ekonomi biznes”.
14. Për profilin “Shërbime për mjete të rënda transporti”, niv. II, në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”
15. Për profilin “Mirëmbajtje ndërtesash”, niv.II, në drejtimin “Ndërtim”

II. Skeletkurrikula të rishikuara:

1. Për drejtimin “Veterinari”, niv. III.
2. Për drejtimin “Teknologji informacioni dhe komunikimi”, niv. I.
3. Për drejtimin “Hoteleri turizëm”, niv. I.
4. Për drejtimin “Pyje”, niv. I.
5. Për drejtimin “Teknologji ushqimore”, niv. I.
6. Për profilin “Teknologji e përpunimit të brumërave”, niv. II, në drejtimin “Teknologji ushqimore”.

III. Materiale mësimore mbështetëse për lëndët profesionale:

1. “Sigurime”, kl.12” të profilit “Sigurime”.
2. “Teknologji e përpunimit të brumit”, kl.12, të drejtimit “Teknologji ushqimore”.
3. “Materiale ndërtimi”, kl.10 të drejtimit “Ndërtim”.
4. “Perime dhe lule”, kl.10 dhe kl.11 të drejtimit “Bujqësi”.
5. “Propiodeutikë”, kl.11 dhe kl.13 të drejtimit “Veterinari”.
6. “Të ushqyerit e kafshëve bujqësore”, kl.12 të profilit “Ferma bujqësore e blegtorale”.
7. “Baza të dhënash”, kl.13 të profileve “Zhvillim ëbsite” dhe “Mbështetje e përdoruesve të TIK”.

8. “Hidraulikë e zbatuar”, kl.10 të drejtimit “Mekanikë”.
9. “Estetika dhe shërbimet speciale në restorant dhe bar”, kl.12 të profileve “Bar-restorant” dhe “Kuzhinë-pastiçeri”.
10. “Njohuri për pijet”, kl.11 të drejtimit “Hoteleri-turizëm”.
11. “Tregti“, kl.12 të drejtimit “Ekonomi-biznes”.
12. “Teknologji për shtrim dyshemesh dhe veshje muresh”, kl.12, të profilit “Shtrim dhe veshje me pllaka”.
13. “Teknik ndërtimi”, kl.10 të drejtimit “Ndërtim”.

IV. Programe të kurseve të shkurtra të formimit profesional:

1. “Shërbimet në bujtina”, 2016
2. “Orientimi i karrierës”, 2016

V. Udhëzues:

1. Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2016-17.